REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE TIRANE
Nr. 844 Rep.
Nr. 76 Kol.

# KONTRATE SHITBLERJE KUOTASH

Sot me date 05.03.2004, diten e premte, para meje Noterit Publik Elsa SINA, me seli ne rrugen "**Mihal Grameno**", u paraqiten personalisht:

SHITES: ALMA **TAFANI**, e bija e Rizait, lindur ne Elbasan, e dtl.1973, me zotesi te plote juridike e per te vepruar, e identifikuar ne baze te pasaportes nr.0165233 banues ne adresen: Rr. "Ded Gj`Luli" pall.1, shk.2, ap.32 Tirane Shqiperi.

BLERES: NIKOLIN **JAKA**, i biri i Frrokut, i dtl.1972, me zotesi te plote per te vepruar, i identifikuar ne baze te pasaportes nr. 0219969, lindur ne Rreshen, e banues ne adresen: Rr."Elbasanit", pall. "Fratari", prapa shkolles se mesme te Gjuheve te Huaja Tirane, Shqiperi.

te cilet rane dakord dhe me kerkuan redaktimin e kesaj kontrate si me poshte :

NENI 1 – OBJEKTI

1.1. Objekt i kesaj kontrate eshte shitja e 50 % te kuotave te kapitalit themeltar te shoqerise "SORI - AL" Sh.p.k. te zoteruara nga shitesi, tek bleresi.
1.2. Shoqeria eshte e regjistruar ne Regjistrin Tregtar prane Gjykates se Shkalles se Pare Tirane me date 15.01.2002 me vendimin nr. 26952.
1.3. Kapitali themeltar i shoqerise "SORI - AL" Sh.p.k. eshte 100.000 dhe zoterohet ne masen 100% nga shitesi, Znj. Alma TAFANI.

NENI 2 – ÇMIMI

2.1. Cmimi me te cilin do te shiten aksionet eshte 50.000 (pesedhjete mije) leke.
2.2. Kjo shume eshte shlyer teresisht nga bleresi jashte kesaj zyre.

NENI 3 – KUSHTET E SHITJES

3.1. Pala blerese gjykohet se ka njohuri te plota per paketen prej 50 % te kapitalit themeltar qe i eshte ofruar per blerje me cmimin e caktuar ne marreveshje te paleve.
3.2. Pales blerese i kalon menjehere pronesia mbi 50 % te kapitalit themeltar te shoqerise "SORI - AL" Sh.p.k.

NENI 4 – TE DREJTAT DHE DETYRIMET E PALES BLERESE.

4.1. Pala blerese ka pranuar blerjen e paketes prej 50 % te kuotave te kapitalit themeltar te shoqerise "SORI - AL" Sh.p.k.
4.2. Pala blerese fiton menjehere te drejten e pronesise mbi 50 % te kapitalit themeltar te shoqerise se blere prej tij.

NENI 5 – TE DREJTAT DHE DETYRIMET E PALES SHITESE.

5.1. Pala shitese garanton palen blerese per pronesine e plote dhe te ligjshme mbi paketen e kuotave objekt i kesaj kontrate.
5.2. Pala shitese garanton te drejtat ligjore te bleresit ne lidhje me pronesine mbi objektin e kesaj kontrate.

NENI 6 – TE NDRYSHME.

6.1. Kjo kontrate iu lexua gojarisht paleve, e cila me kerkesen e tyre perpilohet ne tre kopje te barasvlefshme nga te cilat nje kopje qendron ne zyren e noterit dhe nga nje kopje e marrin palet.
6.3. Palet pasi e kuptuan drejt permbajtjen e kesaj kontrate, e gjeten ate ne perputhje me vullnetin e tyre te lire e te plote dhe e nenshkruan ate pa asnje pretendim.

PALET KONTRAKTUESE

| PALA BLERESE | PALA SHITESE |
| --- | --- |
| NIKOLIN JAKA | ALMA TAFANI |

NOTERE
ELSA SINA